

Shëno me fjalitë e sakta.

- Heroi kombëtar shqiptar quhet Gjergj Kastrioti Skënderbeu.
- Flamuri ynë kombëtar ka ngjyrat bardh e kuq.
- Shqiptarët flasin gjuhën shqipe.
- Shqiptarët festojnë më 28 nëntor Vitin e Ri.
- Më 28 nëntor shqiptarët kudo në botë festojnë ditën e pavarësisë dhe ditën e flamurit.

Lexo vjershën e mëposhtme.

Lapsi kuq e zi

Në dorë marr shpejt e shpejt lapsin tim të ri.
Është lapsi më i bukur, lapsi kuq e zi.
Një zemër vizatoj dhe shqiponjën përbri.
Të dua Kosovë!
Të dua Shqipëri!

Autore: Desara Beqari Gjonej

Kopjoje tekstin e vjershës këtu.
